



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:273016

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06894015

C.nr.2731/23

GJYKATA THEMELORE GJILAN, gjyqtari Arben Xheladini, me bashkëpunëtoren profesionale Ronita Halimi, në çështjen kontestimore të paditëses, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me seli në Prishtinë, adresa Bulevardi Bill Klinton, Nr.5, me numër unik identifikues: 810799364, kundër të paditurit, R.A.T., nga fshati S..i E., Komuna e Gj., me objekt të kontestit kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 63.20 Euro, jashtë seancës, më datë 06.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PËR SHKAK TË MOSBINDJES

I.Detyrohet i padituri, R.A.T., nga fshati S..i E., Komuna e Gj., që paditëses, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., t'ia paguajë dëmin e shkaktuar material në shumë prej 63.20 Euro, me kamatë ligjore 8 % duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjer në pagesën definitive, në afat prej 15 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Më datë 07.12.2023, paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me seli në Prishtinë, e ka filluar procedurën kontestimore kundër të paditurit R.A.T., nga fshati S..i E., Komuna e Gj., me pretendimin se i padituri duhet t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar material në shumë prej 63.20 Euro, me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjer në pagesën definitive. Ka pretenduar se lidhur me këtë dëm të shkaktuar, i padituri nga Gjykata Themelore në Gjilan është shpallur fajtor me aktgjykim penal të formës së prerë P.nr.../22 të datës 12.07.2022, për shkak të veprës penale "v.. e sh.." nga neni 3.. të KPRK-së. Paditësja është udhëzuar në kontest civil, ndwrsa në dispozitiv të aktgjykimit penal është konstatuar se paditësja ka pësuar dëm në shumë 63.20 Euro.

Gjykata ia ka dërguar të paditurit aktvendimin për përgjigje në padi së bashku me të gjitha provat materiale, dhe sipas fletëkthesës i padituri e ka pranuar me rregull më datë 05.11.2024.

Me aktvendimin për përgjigje në padi, i padituri ka qenë i njoftuar për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore në rast të mosparaqitjes së përgjigjes në padi, respektivisht, për mundësinë që në rast të plotësimit të kushteve ligjore, gjykata do të nxjerrë aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë, dhe pavarësisht kësaj, afati tashmë ka kaluar, nuk ka dorëzuar përgjigje në padi.

Baza ligjore

Sipas nenit 150 par. 1 të LPK-së, sipas të cilit: “Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht”.

Pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore, gjykata ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore, për nxjerrjen e këtij aktgjykimi janë plotësuar sepse, padia dhe thirrja për përgjigje në padi të paditurit i janë dorëzuar me rregull, ndërsa, themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi, e po ashtu faktet e treguara nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht, pasi me aktgjykimin penal është konstatuar se dëmi i shkaktuar paditëses është 63.20 Euro.

Lidhur me kamatën gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së, i cili përcakton se “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.

Lidhur me shpenzimet, gjykata vendosi në bazë të nenit 450 dhe 463 të LPK-së sepse, nuk janë kërkuar të specifikuar.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar edhe në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN
C.nr.2731/23, datë 06.02.2025

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.